

Emri i Lëndës : Procedurë Civile							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 322	N/A	Pranverë	3.00	2.00	0.00	4.00	6.00
Lektori		Aranit Qinami, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		E drejta procedurale civile si një nga pjesët e së drejtës studion rregullat e zhvillimit të procesit civil, që bëjnë të mundur të jepet drejtësi duke garantuar si integritetin e rendit juridik, ashtu të drejtat subjektive materiale të subjekteve të ndryshme, qoftë në marrëdhëniet e tyre reciproke, qoftë dhe kundrejt organeve të pushtetit publik dhe duke i ofruar këtyre subjekteve mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme. Me anë të këtij kursi, studentët do të përvetësojnë njohuri mbi parimet, çështjet e kompetencës dhe juridiksionit, aktet e ndryshme procedurale, pra gjykimin në shkallë të parë në tërësi.					
Objektivat		Qëllimi i këtij programi është të pajisë studentët me njohuritë të thelluara për t'u përballur profesionalisht me procedurat gjyqësore civile. Me përfundimin e këtij niveli studimesh, studenti duhet të jetë në gjendje për të kërkuar, analizuar dhe të zgjidhur probleme të çështjeve teorike apo praktike të së drejtës procedurale civile.					
Konceptet Kryesore		1. Parimet e procesit gjyqësor 2. Organizimi i pushtetit gjyqësor 3. Juridiksioni dhe kompetenca 4. Garancitë e vecanta të paanshmërisë së gjyqtarit (Përgjashtimi, Heqja dorë) 5. Ngritja e padisë dhe palët 6. Ndërhyrja e personit të tretë në procesin civil 7. Përfaqësimi në procesin civil 8. Aktet procedurale, njoftimet dhe afatet 9. Pavlefshmëria e akteve 10. Shqyrtimi i çështjes					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Organizimi dhe parimet e procesit gjyqësor- Veprimi i normës procedurale në kohë dhe hapësirë						
2	Juridiksioni dhe kompetenca						
3	Palët në procesin civil- Bashkëndërgjyqësia- Ndërhyrja e personit të tretë						
4	Padia-Sigurimi i padisë						
5	Aktet procedurale, pavlefshmëria e tyre dhe afatet						
6	Gjykimi në shkallë të parë						
7	Hetimi gjyqësor- llojet e provave						
8	Provimi gjysëmfinal						
9	Pezullimi, pushimi i gjykimit dhe dhënia e vendimit						
10	Gjykimi në mungesë - Gjykimet e posacme						
11	Arbitrazhi						
12	Mjetet e ankimit kundër vendimeve gjyqësore- Gjykimi në Apel						
13	Rekursi në Gjykatën e Lartë- Rishikimi i vendimit						
14	Ekzekutimi i detyrueshëm- Përmbaruesi gjyqësor						
15	Mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimit						

16	Provim Final		
Parakushtet		Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura		• 1. Flutura Tafaj, Procedura Civile (Tiranë) 2. KodiiProcedurësCivile 3. Alban Brati Procedura Civile (Tiranë, 2008)	
Referenca të tjera		• Alqiviadh Lamani, Procedura civile e Republikës Popullore të Shqipërisë (Tiranë 1962)	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	1 Studentët do të kenë njohuri të mirëfillta mbi procedurën civile. 2 Studentët do të njihen me konceptet, parimet dhe rregullat e përgjithshme të procesit civil. 3 Studentët do të jenë në gjendje të kërkojë, analizuar dhe të zgjidhe probleme e çështje teorike apo praktike të së drejtës procedurale civile. 4 Studentët do të jenë të pajisur me informacione dhe praktikë gjyqësore të mjaftueshme për t’u dhënë zgjidhje çështjeve konkrete që lidhen me elementë proceduralë.		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme		Sasia	Përqindja
Gjysmë finale		1	30
Kuize		0	0
Projekte		0	0
Projekte semestrare		0	0
Punë laborator		0	0
Pjesëmarrja në mësim		1	20
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	5	80
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	14	14
Provimi final	1	16	16
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			152
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.08
ECTS			6.00